

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004, “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Në Ministrinë e Brendshme, më datë 25.01.2023, është zhvilluar mbledhja e pare e grupit ndërinstytucional të punës, e kryesuar nga Zëvendësministri i Brendshëm, në zbatim të urdhrorit të Kryeministrit nr. 208, datë 27.12.2022 “Për krijimin e grupit ndërinstytucional të punës për përmirësimin e Sistemit Kombëtar të Adresave dhe ndërlidhjen e Regjistrimit Kombëtar të Adresave me bazat e të dhënave shtetërore”, me pjesëmarrjen e anëtarëve të ngarkuar nga urdhri i Kryeministrit.

Më pas grupi i punës është mbledhur dhe në datë 9 shkurt 2023 dhe 23 mars 2023 për identifikimin e grupeve të interesit dhe përcaktimit të metodave të konsultimit.

Në datë 5 tetor 2023 akti ka kaluar për mendim nëpërmjet sistemit të e-akteve tek Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme. Gjithashtu, është dërguar për mendim nëpërmjet emailit të datës 15 shtator 2023 pranë Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, Qendrës Kombëtare të Biznesit, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Postës Shqiptare sh.a, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës, Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Gjithashtu, është parashikuar edhe publikimi në RENJK për periudhën 26 tetor 2023 deri në 26 nëntor 2023, në respektim të afateve ligjore.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitetet nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004, “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar” janë tre:

1. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet, RENJK.
2. Takime me grupin e punës në zbatim të urdhrit nr. 66, datë 16.05.2023 të Ministrit të Brendshëm dhe një takim me grupin ndërinstitucional të punës në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 208, datë 27.12.2022 “Për krijimin e grupit ndërinstitucional të punës për përmirësimin e Sistemit Kombëtar të Adresave dhe ndërlidhjen e Regjistrisë Kombëtare të Adresave me bazat e të dhënave shtetërore”, me pjesëmarrjen e anëtarëve të ngarkuar nga urdhri i Kryeministrit.
3. Komunikime elektronike (nëpërmjet postës zyrtare elektronike).

4. Palët e interesit të përfshira

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
- Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore Për Çështjet e Brendshme,
- Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në MB;
- Koordinatori për konsultimin në MB, për mbledhjen e komenteve nëpërmjet RENJK.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
<i>(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	<i>(grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	<i>(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>		
